



PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS

STATUTI

Kongresi i katërt – IV – Zgjedhor i Partis Rome të Bashkuar të Kosovës (PREBK) i mbajtur më datën 24/02/2013, në Prizren.

Miratoi: Statutin e Partis Rome të Bashkuar të Kosovës (PREBK).

PARIMET THEMELORE

NENI 1

- 1. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS** është politike e Romëve të Kosovës, e cila organizohet si force politike për mbrojtjen e interesave të populates Rome në Kosovë.
- 2. Partia** angazhohet për bashkimin e Romëve me qëllim të krijimit të një force kompakte politike, frytëdhënëse, për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, për mbrojtjen e interesave të pakicës Rome në Republikën e Kosovës, si dhe për mbrojtjen e interesave të Republikës së Kosovës si shtet I pavarur, demokratik dhe Sovran.
- 3.** Ajo përkrah çdo iniciativë paqëndashëse, si dhe përkrahjen në pushtet të pakicave kombëtare edhe të pakicës Rome.

NENI 2

1. **PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS**, është parti politike e themeluar në Kuvendin themelues të mbajtur në Prizren, në vitin 2001.
2. Emri zyrtar i partisë është **PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS**
3. Shkurtesa/Akronimi zyrtar i partis është **PREBK**.

NENI 3

1. Puna dhe aktivitet e **PARTISË ROME TË BASHKUAR TË KOSOVËS** janë publike dhe legale, e hapur për të gjithë opinionin.
2. Në parti mund të anëtarësohen të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim kombi, race, gjinie e përkatësie fetare.
3. Partia përpiqet për ndërtimin e barazisë në mes të qytetarëve dhe të drejtave njerëzore në mes tyre, me theks të veçant në barazin gjinore.

NENI 4

1. Selia/zyra qendrore e **PARTISË ROME TË BASHKUAR TË KOSOVËS**, **gjinden** në Prizren, rruga “Kadri Nesho 26.
2. Ëmblema e partis përmban; mbishkrimin e plotë të emrit të partis në të dyja gjuhët Rome dhe Shqipe, rreth e përçark hartës të Kosovës e cila është e vendosur në mes, në mrendi të hartës janë dy ngjyra; e kaltërt dhe jeshile, dhe shkurtesa e emrit të partis në fund të hartës.

NENI 5

1. **Vula e partis** përmban përshkrimin e plotë të Emblemës së partis, të shkruar në dy gjuhë: në gjuhën Rome dhe Shqipe.
2. Partia e ka të hapur xhirrollogarinë e saj në bankën “ Raiffaisen Bank”

ORGANIZIMI PARTIAK DHE ORGANET

Organet dhe mandatet e tyre

NENI 6

1. **PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS**, është e organizuar në organe qendrore dhe lokale.
2. **Organet qendrore të PREBK-së janë:**
 - a) **Kuvendi**
 - b) **Kryesia**
 - c) **Kryetari**
3. **Mandati i të gjitha organeve të partis është katër (4) vjeçar.**
4. **Organet lokale janë:**
 - a) **Degët**
 - b) **Nën-degët**

NENI 7

1. Kuvendi i **PREBK-së**, është organi më i lartë i partis, I cili formohet nga delegatët e deleguar nga degët.
2. Kuvendi i **PREBK-së**, duhet të ketë 51 delegatë.
3. Kuvendi zgjedhë me vote të fshehtë me kundër kandidat kryetarin e Partis,
4. Në munges të kandidatit të dytë apo të tretë, kuvendi zgjedhë kryetarin me vote të haptë (me aklamacion).
5. Kuvendi merr vendime me 2/3 e votave të delegatëve.

NENI 8

1. Kryesia e **PREBK-së** është organi ekzekutiv i partis që zbaton vendimet e marra në kuvendin e PREBK-se.
2. Kryesia e partis përbëhet nga 15 anëtarë.
3. Mledhjet e partis i thërret kryetari i **PREBK-së**.
4. Mledhjet e Kryesisë mbahen një here në muaj dhe i thërret kryetari i partis.

ORGANIZIMI TERRITORIAL

NENI 9

1. Dega është forma më e lartë e organizimit lokal të **PREBK-së**.
2. Secila prej degëve ka në kuadrin e vet së paku tre nën-degë.
3. Organi kompetent për themelimin e degës është **Kryesia e PREBK-së**
4. Degët e **PREBK-së** janë përgjegjëse për themelimin, organizimin dhe funksionalizimin e nën-degëve të partis.
5. Organet e degës janë
 - a) Kuvendi degës
 - b) Kryesia e degës
 - c) Kryetari e degës

Procesi zgjedhor në Degë

NENI 10

1. **Kuvendi i Degës** përbëhet prej delegatëve të secilës nën-degë, të cilët delegohen nga kuvendi i nën-degës. Numri e delegatëve të Kuvendit të degës, e përcakton **Kryesia e PREBK-së**.
2. **Kuvendi I degës** me vota tëfshehta zgjedhë anëtarët e Kryesisë së Degës.
3. **Kryetari i Degës** zgjidhet nga Kuvendi me votim të fshehtë.
4. **Kryetari I** zgjedhur nga Kuvendi është anëtar i Kryesisë së Degës.

NENI 11

Nën-dega

1. Nën-dega është njësia më e ultë në organizmin e PREBK-së.
2. Nën-dega ka këto organe:
 - a) Kuvendin
 - b) Kryesin
 - c) Kryetarin
3. Delegatët e Kuvendit të nëndegës I cakton Kryesia e Degëve.

KOMPETENCAT E ORGANEVE TE PARTIS

NENI 12

KUVENDI

1. Miraton Programin e **PREBK-së**.
2. Miraton ndryshimin dhe plotësimet e statutit.
3. Miraton Rregulloren e punes.
4. Shqyrton Raportin e punës së **PREBK-së**.
5. Zgjedh Kryetarin e Partis
6. Zgjedh anëtarët e kryesisë.

NENI 13

Kompetencat e Kryesisë

1. Jep propozime për Programin dhe Statutin e **PREBK-së**.
2. Miraton rregulloren për punën e vet dhe përcakton planin e punës.
3. Miraton bugjetin e zgjedhur të **PREBK-së**.
4. Kontrollon (monitoron) strukturat e partis dhe kërkon shpjegime.
5. Mledhjet e kryesisë, mbahen një here në muaj dhe udhëhiqen nga Kryetari i Partise.
6. Mledhjet mbahen, nëse janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të Kryesisë.
7. Themelon degë të reja apo I shton degët të cilat nuk I përmbahen Statutit dhe Programit të **PREBK-së**.
8. Zgjedhë formon komisione për lëmi të ndryshme.

NENI 14

Kompetencat e Kryetarit

1. **Kryetari** është udhëheqësi i **PREBK-së** dhe përfaqëson unitetin e komunitetit Rom.
2. **Kryetarin e zgjedh Kuvendi**
3. **Mandati I Kryetarit** është pesë (5) vjecar.
4. Për punën e tij, Kryetari I pergjigjet Kuvendit.

5. Përfaqëson mbrenda dhe jashtë vendit PREBK-në
6. Udhëheq me punën e aktivitetit politik të parties
7. Kryetari përpilon listen e kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale
8. Menaxhon me Mjetet Financiare të PREBK-së.

INFORMIMI

NENI 15

1. **PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS** do të informoj opinionin e gjerë publik për aktivitetin e saj politik dhe organizativ, përmes mediave të shkruara elektronike si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror.
2. Partia gjithashtu e ka web faqen e saj, ku rregullisht mban të informuar popullaten rreth aktiviteteve të saj.

NENI 16

Dispozitat perfundimtare

1. **Ky statut u aprovua në Kuvendin e partis me datën 24/02/2013.**

NENI 17

1. Statuti hyn në fuqi në ditën e aprovimit të tij.

NENI 18

1. Ndryshimet dhe plotesimet e këtij Statuti bëhen me procedure të njejtë sikurse është aprovuar

PRIREN
07/06/2015

Kryetari I PREBK-së
Albert Kinolli